Co-PLAN GAZETTE

Publikim Gjashtëmujor i Co-PLAN, Instituti Për Zhvillimin e Habitatit Gazeta Nr.7 Janar 2015







ENV.Net

Rreth projektit ""Zhvillimi i ENV.net në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: T'u japim qytetarëve një zë për të ndikuar mbi reformat e proceseve mjedisore për integrim më të afërt në BE". **(fq. 6)**

DOKUMENT POLITIKASH

Sektori i ndërtimit aktualisht përbën konsumatorin më të madh të energjisë në botë me rreth 40% të totalit të energjisë së konsumuar. Si mund të rritet efiçienca e energjisë? **(fq.3-5)**

STOKU I BANESAVE SOT

Një prezantim interesant mbi materialet e insulimit të tejdukshëm, llojet, dhe parimet e zbatimit me shembuj konkretë shkëputur nga qytetet Shqipëtare.

(fq. 9-10)

AKTE TË GJELBRA

Eksperienca dhe momentet kyçe nga projektet e mundësuara nga grantet e akorduara nga ENV.net katër organizatave lokale mjedisore në Shqipëri.


(fq.7-8)

EFIÇIENCA E ENERGJISË DHE PËRFITIMET E SAJ

Nga zhvillimet në sektorin e sigurimit të energjisë, ndikimet ekonomike të çmimeve të larta të energjisë, si dhe ndërgjegjësimin në rritje të ndryshimit të klimës është bërë e qartë se sjellja jonë ndaj energjisë duhet të ndryshojë urgjentisht, duke çuar në rritjen e vëmendjes drejt efiçiencës së energjisë.

Efiçienca e energjisë, shpesh e njohur si lënda djegëse e padukshme me potencial të madh të pashfrytëzuar, është gjithnjë e më shumë duke u parë si një burim kyç për zhvillimin ekonomik dhe social në të gjitha ekonomitë, duke përfshirë edhe ato në zhvillim. Në fakt, shifrat e raportuara nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (IEA, 2014) flasin për përfitime të rëndësishme të prekshme në terma monetare: Kursimi i energjisë në vendet anëtare të IEA-s në 2010 ishte më i madh se kërkesa aktuale për energji e plotësuar nga një burim i vetëm, përfshirë këtu naftën, gazin, qymyrin dhe energjinë elektrike - duke e vendosur efiçiencën e energjisë në pozitat e një lënde parësore.

Duke pasur parasysh qëllimin dhe madhësinë e përfitimeve që lidhen me masat e efiçiencës së energjisë dhe investimeve, etj., ekspertë të fushës janë gjithnjë e më shumë duke advokuar një qasje multi-sektoriale për studimin dhe matjen e përfitimeve të shumta nga eficienca e energjisë. Në fakt, studimet kanë identifikuar një numër fushash që shkojnë përtej reduktimit të konsumit të energjisë dhe nivelit më të ulët të emetimeve të gazrave serë, në të cilat përfitimet e qarta të efiçiencës së energjisë janë të dokumentuara në fusha të tilla si shëndeti dhe mirëqenia,



Burimi: IEA 2014

prodhimi industrial, buxhetet publike, manaxhimi i burimeve, ndotja e ajrit lokal, zbutja e varfërisë, sigurimi dhe ofrimi i energjisë, etj.


Edhe pse shumica e përfitimeve të përmendura vijnë nga vendet që kanë vite që promovojnë dhë investojnë në rritjen e eficiencës së energjisë, përfshirë këtu dhe në nivel vendimmarrës, për vende si Shqipëria, qasja multi-sektoriale ndaj efiçiencës së energjisë përbën një

Co-PLAN
POLIS MetroPolis
Instituti për Kërkim dhe Zhvillim - IKZH_POLIS

© Kjo gazetë, përfshirë dhe imazhet nuk mund të riprodhohen, pjesërisht apo tërësisht, pa pëlqimin e autorëve dhe Co-PLAN.

Efiçienca e Energjisë dhe përfitimet e saj (vazhdim)

Potenciali ekonomik afat-gjatë i Efiçiencës së Energjisë sipas sektorit (IEA, 2014)



Burimi: IEA 2014

pikë fillimi të rëndësishme.


Në fakt, ndërgjegjësimi dhe promovimi i masave të efiçiencës së energjisë, edhe pse ende në një fazë të hershme, ka filluar dhe në Shqipëri. Në nivel vendimmarrje, në kuadër të Strategjisë Kombëtare Shqiptare të Energjisë (ANSE), qeveria ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit për Efiçiencën e Energjisë (NEEAP) për periudhën 2010-2018. Plani i Veprimit përcakton si objektiv reduktimin në masën 9% deri në vitin 2018, ndërkohë që synohet dhe përafërimi i kornizës ligjore Shqiptare me *acquis* të BE-, dhe në veçanti me "Direktivën 2006/32 / EC e dt. 5 prill, 2006 mbi" Efiçiencën e Energjisë të përdorimit fundor dhe shërbimeve të energjisë ", Direktivën 2002/91 / EC mbi "Sjellja Energjitike e Ndërtesës ", dhe me Direktivën 92/75 / EC i quajtur gjithashtu" Direktiva e Etiketimit të Energjisë ".

Nevoja për rritjen e ndërgjegjësimit, të kuptuarit dhe promovimit të masave të efiçiencës së energjisë dhe përfitimeve të saj, si dhe të ngritjes së kapaciteteve, është reflektuar edhe në përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile të tilla si Co-PLAN, shpesh në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë. Studimet mbi transpozimin e *acquis* në kuadrin tonë ligjor në funksion të procesit të integrimit në BE, monitorimi i zbatimit të tij, vlerësimi dhe promovimi i rehabilitimit energjitik të ndërtesave përmes projekteve pilot, janë vetëm disa nga shembujt e ndërmarjeve konkrete.

Gjithashtu, duke marë parasysh mungesën e kapaciteteve në fushën e efiçiencës së energjisë, Universiteti POLIS, në bashkëpunim me Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, dhe nëntë partnerë të tjerë europianë kanë filluar programet profesionale për eficiencën e energjisë si pjesë e projektit TEMPUS "Zhvillimi dhe Përshtatja e Programeve Profesionale mbi Efiçiencën Energjitike në Ballkanin Perëndimor".

Për të çuar më tej zhvillimet në fushën e efiçiencës së energjisë, ekzistojnë një numër sfidash për t'u adresuar; duke filluar nga mënyrat si ne aktualisht prodhojmë dhe

Konsumi final i energjisë parësore sipas sektorëve në vitin 2012



Burimi: INSTAT dhe Ministria e Energjitikës, Co-PLAN

përdorim të dhënat për eficiencën e energjisë, shpesh të mara nga bilancet energjetike për të zhvilluar indikatorë agregatë (të tilla si energjia totale për frymë).

Edhe pse të dhënat e tilla mund të vënë në dukje trende interesante të konsumit të energjisë, për shkak të ndikimit ndërsektorial që efiçienca e energjisë ka, të dhënat mund të prodhojnë interpretime çorientuese: konsumi i përgjithshëm përfundimtar i një vendi kundrejt prodhimit të brendshëm bruto (PBB) apo për frymë jo domosdoshmërisht përcakton renditjen performancës energjitike të atij vendi, duke qenë se janë një numër faktorësh që ndikojnë në renditje si p.sh. klima, struktura ekonomike, etj.

Eshtë e rëndësishme që përfitimet potenciale të efiçiencës së energjisë në të gjithë sektorët e ndryshëm të analizohen, maten, dhe të artikulohen në vlera monetare, kështu që çdo përshtatje e nevojshme në nivel politikash apo kornizash ligjore të jetë bazuar në argumentë të shëndoshë e koherentë për kontekstin Shqipëtar.


Për të kontribuar më tej në diskutimin dhe eksplorimin e aspekteve të tjera të efiçiencës së energjisë veçanërisht të përshtatshme për kontekstin shqiptar, Co-PLAN në bashkëpunim me rrjetin Env.net sjellin një Gazetë të dedikuar tërësisht për çështjet e efiçiencës së energjisë.

Dokument POLITIKASH - Rekomandime për Rritjen e Performancës Energjitike të Stokut të Banesave në Vend

Nisur nga rëndësia dhe nevoja për rritjen e performancës së energjisë, veçanërisht në sektorin rezidencial në Shqipëri, Co-PLAN ka ndërmarrë një studim të stokut të banesave në qytete të ndryshme të vendit, gjetjet e të cilit janë përmbledhur në formën e rekomandimeve në këtë dokument politikash.

Studimi fokusohet në stokun e banesave të ndërtuara para viteve 90-të, si një pjesë e konsiderueshme e sektorit rezidencial, të cilat paraqesin nevoja emergjente për ndërhyrje rehabilituese, dhe njëkohësisht si një potencial i madh për të kursyer duke rritur performancën e tyre energjitike nëpërmjet ndërhyrjeve termoizoluese të mureve të jashtëm. Duke u bazuar në një metodologji të ndjekur në një studim të ngjashëm për disa vende të BE-së, janë analizuar kostot dhe përfitimet për nivele të ndryshme të termoizolimit të mureve të jashtme të disa ndërtesave përfaqësuese të stokut të ndërtesave përkatësisht në qytetet e Tiranës, Fierit dhe Korçës si qytete me tre tipologji të ndryshme, me qëllim përcatimin e vlerave optimale nga pikëpamja ekonomike si dhe parametrat dhe faktorët që optimizojnë investimet dhe masat për eficiencën e stokut të ndërtesave.

Konsumi i Energjisë Elektrike nga Konsumantorët në MWH



Burimi: INSTAT dhe Ministria e Energjitikës, Co-PLAN

Ku jemi sot? Konstatime të performancës energjitike të stokut të ndërtesave

Bashkimi Evropian (BE) në Paketën për Klimën dhe Energjinë, ka përcaktuar ligjërisht që në vitin 2020, vendet e Bashkimit Europian marrin zotim të përmbushin objektivat 20-20-20, më konkretisht: reduktim me 20% të emetimeve të gazeve serë në raport me nivelin e vitit 1990, dhe përmirësim me 20% të nivelit të eficiencës së energjisë në BE. Ndërkohë në një plan progresiv afatgjatë, sygjerohet të reduktohen emetimet e gazeve serë respektivisht me 40% në 2030, 60% në 2040 dhe 80% në vitin 2050 . Ndërsa në shumë vende evropiane dhe kandidate nisma "20-20-20" është transmetuar dhe transpozuar në angazhime ligjore përkatëse, Shqipëria është i vetmi vend që ende nuk ka vendosur objektiva konkrete dhe nuk ka reformuar kuadrin ligjor dhe rregullator në zbatim të saj. Për më tepër, siç vërehet në Raport Progresin Europian për vitin 2014, për Shqipërinë, akoma nuk ka një strategji të përshtatshme për t'u përballur me ndryshimet e klimës dhe ndikimin e saj.


Përpos kësaj, në kuadër të diskutimit të Eficiencës së Energjisë, Direktiva Evropiane për Performancën Energjitike në Ndërtesa (EPBD) parashikon të përmirësojë eficiencën energjitike të ndërtesave të reja dhe atyre ekzistuese në të gjithë vendet anëtare dhe potencialisht në të ardhmen edhe në vendet kandidate siç është Shqipëria. Sipas EPBD-së, çdo vend i BE-së duhet të vendosë kërkesa/standarte minimale (dysheme) lidhur me performancën energjitike të ndërtesave dhe elementëve përbërës të tyre. EPBD përcakton gjithashtu se, prej vitit 2020 çdo ndërtesë e re në vendet anëtare të BE-së, duhet të shkojë drejt një konsumi minimal, pra të ashtuquajturave ndërtesave "me energji gati zero". Gjithashtu, Shqipëria ka ratifikuar Traktatin e Energjisë dhe Protokollin për Eficencën e Energjisë dhe Aspektet Mjedisore (PEEREA) që më 1997. Duke ratifikuar PEEREA-n vendi ynë angazhohet të formulojë dhe zbatojë politikat për përmirësimin e eficencës së energjisë dhe reduktimin e efekteve negative mjedisore të ciklit të energjisë.

Nisur nga aspiratat e Shqipërisë si vend kandidat për të qenë anëtare e BE-së, këto standarte/kritere do të jenë të aplikueshme dhe të detyrueshme për tu zbatuar edhe për stokun e ndërtesave në Shqipëri.

Për të kuptuar përmasat e nevojave dhe hapat që duhet të ndërmarren, është e rëndësishmë të marrim në konsideratë situatën aktuale në vend, statusin ligjor, rregullator e institucional në fuqi, gjëndjen e stokun të ndërtesave, si më poshtë vijon:

1. Duke iu referuar burimeve zyrtare sektori i ndërtesave përbën sektorin më të madh të konsumit të energjisë në ekonominë tonë me rreth 34% e të gjithë energjisë së shpenzuar. Përveç konsumit të madh të energjisë elektrike, ky sektor konsumon rreth 83.7% të të gjithë sasisë totale të drurit si lëndë djegëse dhe 3.8% të produkteve nga hidrokarburet. Konsumi i lartë i energjisë nga sektori i ndërtesave lidhet kryesisht me performancën e ulët energjitike të stokut ekzistues të ndërtesave, por edhe për shkak të përdorimit jo efektiv të energjisë në to.
2. Nisur nga studimi i kryer nga Co-PLAN lidhur me performancën energjitike të stokut të banesave, rastet më problematike vërehen kryesisht tek banesat e ndërtuara gjatë periudhës 1950-2000 (psh. pallate parafabrikat), ndërkohë vetëm vitet e fundit jane vërejtur disa ndërtesa me performancë më të lartë energjitike për shkak të aplikimit të termoizolimit të mbulesës së jashtme të ndërtesave.
3. Deri më sot, ka munguar interesi nga ana e ndërtuesve për të ndërtuar me materiale dhe sipas parimeve të efiçiencës energjitike, sikurse dhe angazhimi i autoriteteve për të siguruar zbatimin e kërkesave ligjore për këtë qëllim. Bazuar në studime të kryera nga Co-PLAN, rezulton që kjo situatë të jetë për shkak se:

a. Për të ndërtuar me konsiderata energjitike ndërtuesit janë përballur me implikime financiare shtesë, ndërkohë që tregu i pasurive të paluajtshme nuk ka reflektuar këto përmirësime në vlerë monetare.
b. Blerësit dhe publiku në përgjithësi kanë qenë të painformuar dhe rrjedhimisht të painteresuar ndaj ndërtimeve me konsiderata energjitike.
c. Efiçienca e energjisë së ndërtesave nuk ka qenë prioritet për autoritetet dhe vendimmarrësit.
d. Kanë munguar kapacitetet, njohuritë dhe instrumentat praktike për vlerësimin dhe kontrollin e parametrave energjitike.
e. Ka munguar deri tani një kuadër



Burimi: INSTAT Pergatiti: Co-PLAN

rregullator, fiskal, etj., që do të nxiste ndërtimin/ rikonstruktimin me performance energjitike.

4. Së fundi, vihet re një interes më i madh nga grupet e interesit, si sektori i ndërtimit dhe publiku ndaj masave për efiçencën energjitike të ndërtesave kryesisht për shkak të rritjes së vazhdueshme të çmimit të energjisë elektrike dhe rrjedhimisht të kostos së energjisë për ngrohje dhe ftohje.

5. Njëkohësisht, institucionet po shfaqin një vëmendje më të madhe dhe një qasje pro-aktive për të përmbushur detyrimet kombëtare dhe ato që lidhen me integrimin. Po punohet shpejt për përafrimin e kuadrit ligjor dhe standarteve për efiçiencën energjitike në përputhje me direktivat europiane. Këto përmirësime ligjore dhe rregullatore pritet të vijohen me ndërmarrjen e masave për përmirësimin e performancës energjitike në stokun ekzistues dhe në ndërtesat e reja, si detyrime që vendi ynë duhet ti ndërmarrë në të ardhmen si pjesë e përpjekjeve për t'u integruar në BE.

2. Si mund të përmirësohet situata? Konsiderata me rëndësi për përmirësimin e performancës energjitike.


Duke marrë në konsideratë që ndërtesat kanë një cikël rehabilitimi çdo 30-50 vite , atëherë çdo ndërtesë që ndërtohet apo rehabilitohet sot në Shqipëri, do të jetë pjesë e stokut të ndërtesave në vitin 2050. Kjo do të thotë që për të arritur objektivat e vitit 2050, duhet të planifikohet që tani për ndërtesat e reja apo dhe ato që janë objekt rehabilitimi.

Për të kontribuar në këtë proces, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit bazuar në studimin analitik të ndërmarrë për përmirësimin e performancës së eficiencës së energjisë në qytete të ndryshme të Shqipërisë (Tiranë, Fier, dhe Korçë si qytete me tri tipoligji të ndryshme), nëpërmjet termoizolimit të mureve të ndërtesave të jashtme parashtron rekomandimet e mëposhtme:

1. ***Ndërmarja e rehabilitimit energjitik në stokun ekzistues të banesave*** - Një pjesë e mirë e banesave në vend janë pjesë e stokut ekzistues të ndërtuara përpara vitete 90të, me performancë të ulët energjitike veçanërisht të veshjes së tyre të jashtme. Kjo kategori përbën një potencial të madh për përmirësimin e kursimit energjitik në këto banesa.

2. Një ndër masat më të efektshme dhe praktike për të përmirësuar performancën energjitike të stokut të ndërtesave rezulton ***ndërhyrja në termoizolimin e veshjes së jashtme të ndërtesës, përkatësisht në termoizolimin e mureve të jashtme, tarracës, çatisë apo të dritareve***, etj., pasi:

- Termoizolimi i veshjes së jashtme të ndërtesave mundëson përmbushjen e kërkesave ligjore sipas kodit energjitik të ndërtesave pavarësisht nivelit aktual të stokut ekzistues. Gjithësesi nevojitet një analizë më e thelluar lidhur me efektivitetin e masave përmirësuese për komponentët e tjerë të veshjes së ndërtesës për të përmbushur kërkesat ligjore të gjithë ndërtesës.
- Përfitimet nga kursimi i energjisë për periudhën e ciklit të jetës së ndërhyrjes , tejkalojnë koston e plotë të investimit . Kjo është e vërtetë për rastin e komponentit të murit të jashtëm, por mund të jetë i vërtetë apo i ngjashëm edhe për komponentët e tjerë.
- Standartet minimalë (U) në zbatim të EPBD ashtu dhe standartet më ambiciozë për mbrojtjen e klimës, rezultojnë të arritshëm dhe me kosto efektive. Gjithësesi optimizimi ekonomik i termoizolimit të stokut të ndërtesave do të përmirësohej nga rritja e efektivitetit të teknikave të termoizolimit dhe fuqisë punëtore, uljen e kostos së kredisë si dhe rritjen e çmimi të energjisë.




Burimi: INSTAT Pergatiti: Co-PLAN

3. ***Të dizenjohen dhe promovohen skema lehtësuese dhe partneritete ndërmjet aktorëve për të inkurajuar ndërhyrjet për termoizolim të banesave***. Ndërhyrjet për termoizolimin e mureve të ndërtesave kërkojnë investim të konsiderueshëm, ndaj dhe lind nevoja për politika/masa lehtësuese. Nëpërmjet dizenjimit dhe promovimit të skemave lehtësuese apo partneriteteve me sektorin bankar, do të mundësohej përballimi me më lehtësi i kostove të mëposhtme:

- Kostot fikse - varjojnë në 52-84% të kostos së plotë të investimit.
- Kostot e kredisë - rrit konsiderueshëm koston kapitale të investimit. Në Shqipëri kosto e kredisë rezulton rreth 40% më e lartë se ajo në vendeve të BE-së .


4. ***Mbajtja e koeficientit të transmetimit të nxehtësisë në normat 0.4-0.5W/m²K*** - Që stoku i ndërtesave në qytetin e Tiranës të përmbushë objektivat klimatikë (të reduktojë me 80% nevojën për energji krahasuar me nivelin e vitit 1990 (në analogji me studimin e ECOFYS, 2007) , nevojitet që koeficienti i transmetimit të nxehtësisë, i njohur si vlera "U", të murit të jashtëm të variojë midis 0.4-0.5W/m²K , e përafërt me vlerën "U" optimale nga pikëpamja ekonomike dhe e arritshme nëpërmjet termoizolimit të mureve të jashtme. Kjo do të thotë që standartet e kërkuara termike për përmbushjen e objektivave të klimës për qytetin e Tiranës janë të arritshme nëpërmjet aplikimit të një shtrese termoizolimi prej 6cm trashësi. Një rezultat i tillë vlen edhe për qytete të tjerë, ku trashësia e rekomanduar për termoizolimin e murit të jashtëm për shembull për qytetin e Korçës është 10cm dhe për qytetin e Fierit është 5cm, për të arritur respektivisht vlerat "U" optimale 0.35 W/m²K në Korcë dhe 0.63 W/m⁻K në Fier.

Vlerat "U" për një ndërtesë TIP në Tiranë (si përfaqësuese e stokut të ndërtesave në vitin 1990) dhe vlerat e nevojshme për të reduktuar konsumin e energjisë përkatësisht me 80%.



Burimi: INSTAT Pergatiti: Co-PLAN

Analiza ekonomike për termoizolimin e murit të jashtëm (vetëm për ngrohje)"



Burimi: INSTAT Pergatiti: Co-PLAN

ENV.net

Rreth projektit "Zhvillimi i ENV.net në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: T'u japim qytetarëve një zë për të ndikuar mbi reformat e proceseve mjedisore për integrim më të afërt në BE.

Prej vitit 2013 Co-PLAN është pjesë e rrjetit Env.Net, i krijuar për të ndikuar mbi reformat e proceseve mjedisore për integrim në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi. Rrjeti synon rritjen e angazhimit dhe të kapaciteteve të partnerëve dhe organizatave mjedisore të shoqërisë civile për të ndikuar në proceset e reformave të sektorit publik në sektorin mjedisit përmes analizës, monitorimit dhe mbrojtjes dhe për të mirëpritur standardet e ligjeve mjedisore. Co-PLAN është fokusuar veçanërisht në legjislacionin e manaxhimit të burimeve ujore, dhe eficiencës së energjisë, ku ka thelluar punën kërkimore për sa i takon transpozimit të këtij legjislacioni dhe zbatimit të tij. Rezultatet e kësaj punë kërkimore kanë shërbyer për hartimin e rekomandimeve për përmirësime të cilat janë ndarë gjerësisht me politikëbërës dhe grupe interesi.

Rjeti Env.Net, i formëzuar nga projekti me të njëjtin emër, synon të shpërndajë eksperienca dhe praktika me organizata dhe rrjete të tjera që operojnë në fushën e mjedisit. Aktualisht rrjeti përbëhet nga shtatë organizata, përkatësisht: Fondazione punto.sud (Itali); Advocacy Training & Resource Center, ATRC (Kosovë); Co-PLAN, Institute for Habitat Development (Shqipëri); Environment Ambassadors for Sustainable Development, EASD (Serbi); European Environmental Bureau, EEB (Belgjikë); TEMA, The Turkish Foundation for Combating Soil Erosion, for Reforestation and the Protection of Natural Habitats (Turqi); 4x4x4 Balkan Bridges (Maqedoni).



Projekti

Projekti ndërton mbi përvojën e një projekti të financuar nga BE-ja, konkretisht "Forumi Mjedisor", i zbatuar në periudhën 2009-2012, me synim zhvillimin e kapaciteteve të OJF-ve mjedisore për të ngritur një dialog konstruktiv me autoritetet shtetërore.
Qëllimi i projektit Env.Net është të arrijë një angazhim dhe kapacitet më të madh të partnerëve për t'u dhënë qytetarëve një zë dhe për të ndikuar në proceset e reformave të sektorit publik në sektorin e mjedisit përmes analizës, monitorimit dhe mbrojtjes dhe për të mirëpritur standardet e ligjeve mjedisore. Viti 2015 shënon dhe fillimin e fazës së dytë të projektit.

Përgjatë fazës së parë, strategjia e projektit u përqëndrua në punën për forcimin e kapaciteteve të organizatave partnere të ENV.net në analizim, monitorim, mbrojtje të çështjeve mjedisore. Pas kësaj faze, partnerët duhet të jenë në gjendje të shkëmbejnë përvojat dhe njohuritë me OSHC-të mjedisore të vendeve të tyre me mbështetjen e projektit nëpërmjet sesioneve të trajnimit dhe një helpdesku. Ky proces ka shërbyer që OSHC-të e çdo vendi të përmirësojnë aftësitë për të promovuar ndërgjegjësimin për çështje të ndjeshme mjedisore mes shoqërisë civile (rrethi i tretë), duke pasur mundësi të përmirësonin dialogun dhe të ndikonin mbi qeveritë kombëtare, institucionet e BE-së dhe aktorë të tjerë të mundshëm në përshtatjen e politikave specifike për të lehtësuar procesin e përafrimit të ligjeve mjedisore dhe në përmirësimin e mjedisit dhe të fuqisë së OSHC-ve.

Përgjatë fazës së dytë partnerët do të fokusojnë përpjekjet e tyre për të zhvilluar struktura për monitorimin sistematik, përmes mbledhjes së informaciont lidhur me pjesët specifike të legjislacionit mjedisor dhe përdorimin e një sistemi më të strukturuar dhe të përbashkët të monitorimit. Për këtë arsye, do të ngrihet një sistem i përbashkët komunikimi me aktorë e grupe interesi të fushës, si media, autoritete kombëtare e lokale, OSHC, etj., për të stimuluar një reagim sistematik në lidhje me mangësitë, apo praktikat e mira mbi përafërimin me acquis. I gjithë ky informacion do të vazhdojë të shpërndahet përmes faqes së internetit të Env.Net, Co-PLAN, si dhe rrjeteve sociale.

Për të mbështetur procesin e fuqizimit të organizatave të shoqërisë civile në nivel lokal, si dhe nismat lokale mjedisore, përgjatë vitit 2014, Co-PLAN në bashkëpunim me rrjetin Env.Net mbështetën katër organizata lokale.

Akte të Gjelbra

Nisma Lokale për Energjinë e Rinovueshme

Nisma për vlerësimin e mundshëm të burimeve të energjisë së rinovueshme në jug të Shqipërisë dhe nxitja e nismave për t'i përdorur këto burime për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit u ndërmor nga Aarhus Information Centre në Vlorë, në muajt prill-qershor 2014. Mbështetur në një përvojë të mëparshme të krijimit të Komisioneve të mbështetura tek bashkia (një shoqatë e përbërë nga qytetarë, gra, të rinj dhe këshilltarë vendorë e themeluar në Vlorë nga Aarhus Information Centre në vitin 2013), u organizuan takime përgatitore në tri bashkitë kryesore të jugut të vendit (Orikum, Himarë dhe Sarandë). Zyrtarë të lartë vendorë, përfaqësues të lartë të institucioneve publike, përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, këshilltarë, biznesmenë, përfaqësues të institucioneve financiare, donatorë të mundshëm dhe shoqëria civile u mblodhën së bashku në këto takime, ku u zhvillua një dialog mbi nismat për energjinë e rinovueshme mes zyrtarëve të qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat në nivel lokal, përmes forcimit të mekanizmave të pjesëmarrjes së publikut. Përmes ecurisë të projektit, u zhvillua një fushatë ndërgjegjësimi publik për rolin dhe dobitë e energjisë së rinovueshme kundrejt burimeve të energjisë jo të rinovueshme në të tria bashkitë duke shpërndarë postera dhe fletëpalosje në takime në rrugë, forume publike, intervista dhe takime, përmes mediave sociale dhe mediave lokale. Po ashtu, bashkësisë, sektorit të biznesit dhe qeverive vendore iu shpërndanë informacione të hollësishme teknike për burimet e energjisë së rinovueshme dhe panelet diellore. Gjatë projektit, interesi i bashkësisë ishte shumë i lartë për përparësitë në përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme krahasuar me burimet e tjera, por edhe për çmimin, instalimin e duhur dhe jetëgjatësinë e paneleve diellore, duke pasur parasysh njohuritë tepër të pakta deri atëherë.

Energji e Rinovueshme për Fshatin pa Energji


Nisma për nxitjen e teknologjive të energjive të rinovueshme për të furnizuar me elektricitet mjediset që nuk janë të lidhura me rrjetin e energjisë, u ndërmor nga Grupimi Eko Lëvizja, gjatë muajve mars-korrik 2014. Mungesa e energjisë elektrike është ende problem në vend, sidomos në zonat e largëta, të cilat gjenden larg zonave urbane dhe rrjetit energjetik. Gjatë kësaj nisme, u identifikuan gjashtë fshatra në gjithë vendin (Rrajcë, Qarrisht, Saraqinisht, Finiq, Rrogozhinë, dhe Kuç), ku u përzgjodhën 6 mjedise për instalimin e 6 paneleve fotovoltaike (12 volt me 5 llamba LED) për të prodhuar elektricitet nga dielli. Pronarët e këtyre mjediseve u kontaktuan dhe u vizituan nga përfaqësuesit e Eko Lëvizjes, ku u njohën me këtë teknologji dhe si mund të përfitonin nga përdorimi i saj. Pasi treguan historitë e tyre dhe se si u mungonte elektriciteti nëpër mjediset e baxhove, bletarive, depove dhe stallave të bagëtive, ideja e përdorimit të paneleve fotovoltaike për të prodhuar energji elektrike në mjediset e tyre pa dritë, u dukej përherë e më tepër bindëse.

Promovimi i Eficiencës së Energjisë në Shkolla përmes ndriçimit LED

Një tjetër projekt i financuar nga Env.Net është ai i promovimit të standardeve të efikasitetit të energjisë në shkolla përmes orëve të edukimit mbi përdorimin me efikasitet të energjisë në ndërtesa dhe ndërhyrjet konkrete për të përmirësuar performancën e energjisë në ndërtesat publike nga Milieukontakt Albania gjatë muajve mars-korrik 2014. Projekti ishte përqendruar në orët e edukimit për energjinë, auditimi i energjisë dhe ndriçimi i ndërtesave të shkollave publike në Tiranë. Nxënësit e shkollës publike, "Xhezmi Delli" ndoqën orë të hapura ku u paraqitën konceptet bazë të energjisë së rinovueshme, efikasiteti energjetik dhe dobitë e saj për ekonominë e mjedisin. Filma të shkurtër ilustruan ndërhyrje praktike për të përmirësuar efikasitetin energjetik në ndërtesa si termoizolimi, riparimet në rrjetin elektrik, sistemet e ngrohjes qendrore në shkolla dhe përdorimin e llambave ekonomike LED. Një ekspert i jashtëm asistoi shkollën për raportin e auditimit të energjisë, ku gjatë procesit u angazhuan nxënës së bashku me stafin mësimor. U organizuan disa takime dhe inspektime në shkollë gjatë përgatitjes së raportit të auditimit, ku u analizuan të gjitha format e energjisë së përdorur, sa efikase është ndërtesa, u llogarit kostoja reale e energjisë së shpenzuar e paguar, e ndjekur kjo me rekomandime për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesë










Të bashkohemi për të kryer punë

Në kuadrin e nismës ditore "Të pastrojmë Evropën" të përhapur në të gjithë vendet e BE-së, Co-PLAN, së bashku me QKBZh (Qendrën për Kërkime, Bashkëpunim dhe Zhvillim) të vendosur në qytetin e Vlorës, në kuadrin e projektit ENV-net, organizuan një ditë pastrimi më 9 maj, (2014) me moton "Të bashkohemi për të kryer punë". Më tepër së 130 nxënës nga tri shkolla të ndryshme të qytetit u përfshinë në pastrimin e territoreve të shkollave dhe mjedisit rreth tyre, dhe në vijën bregdetare të Vlorës, pasuar nga disa veprimtari edukative në fushën e mbajtjes pastër të mjedisit. Veprimtarisë iu bashkuan edhe përfaqësues të Drejtorisë Rajonale e Arsimit të Vlorës dhe të Bashkisë së Vlorës, ku kjo e fundit ndihmoi me transportimin e gjithë mbetjeve të mbledhura nga nxënësit në landfillin e qytetit.

PROJEKTI "KAPSULA SOLARE" NGA U_POLIS





Kapsula Energjitike, e ideuar dhe realizuar nga Universiteti POLIS, është një strukturë e ndërtuar tërësisht nga materiale me eficencë të lartë energjitike, për promovimin e masave për rritjen e Eficencës së Energjisë, veçanërisht në sektorin e banimit.

Struktura është ndërtuar bazuar në parimet e efiçiencës së energjisë në banesa , me materiale si *aquapanels*, dyer dhe dritare me performancë shumë të lartë energjitike (me koeficent $\lambda =$ 0.9).

Shumica e materialeve për ndërtimin e kapsulës u siguruan nga dy kompanitë nga kompanitë lider në tregun e materialeve të ndërtimit me eficiencë të lartë energjitike, KNAUF dhe REHAU.

Në një aktivitet promovues të organizuar në kuadër të Ditëve të Kursimit të Energjisë më 18-19 Dhjetor, 2014, Përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Bashkisë Tiranë, së bashku me Universitetin POLIS dhe Co-PLAN adresuan gjerësisht çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e sektorit të eficiencës së energjisë.

"Kapsula Energjitike", ndërtimi i së cilës u mbështet dhe nga projekti ENV.net do të shërbejë si një laborator lëvizës për demonstrimin e parimeve dhe teknikave të të ndërtuarit me materiale me performancë të lartë energjitike.





Gjendja e Stokut të Banesave në Vend dhe Potenciali i Tyre Energjitik



Në vendin tonë sot numërohen rreth 600,000 ndërtesa për qëllime banimi, prej të cilave rreth 338,896 (Instat, 2014) janë të ndërtuara gjatë viteve 1945-1990. Në varësi të vitit të ndërtimit ndërtesat dallojnë mes tyre sipas llojit të materialeve të ndërtimit, parimet e ndërtimit, cilësisë dhe arkitekturës (formave gjeometrike, përmasat dhe pamja e ndertesave, etj.), që lidhen kryesisht me kohën e ndërtimit te tyre. Duke qenë se mosha e stokut të ndërtuar para viteve 90-të varjon nga 25-70 vjeç, rehabilitimi apo rigjenerimi i tyre përbën një domosdoshmëri , për shkak të gjëndjes fizike të ndërtesës, shkallës së amortizimit të saj, sjelljes energjitike, humbjeve termike, etj.

Deri më sot nuk ka një inventar të plotë të karakteristikave të ndërtesave dhe materialeve të përdorura, por nga analiza të kryera nga Co-PLAN, kryesisht dallohen ndërtesa me çati apo me tarracë, ku materialet më të përdorura për muret janë parafabrikatë, tullat me vrima ose të plota, druri etj. Duke ju referuar po të njëjtit studim, në stokun e ndërtesave të banimit në Qarkun e Tiranës rezulton se 78.1% e ndërtesave janë të suvatuara, 16.9% e tyre janë të pasuvatuara dhe vetëm 4.9% të termoizoluara. Ndërtimi i banesave të pasuvatuara, kryesisht në formën e parafabrikatëve, ka qenë dominant gjatë viteve '60 –'90, qartësisht e lidhur me teknologjinë e ndërtimit me kosto të ulët e kushtëzuar nga kërkesa e madhe në tregun e banesave në atë periudhë.

Një tjetër karakteristikë e ndërtesave në Rajonin e Tiranës është që në shumicën e rasteve janë pa sistem qendror ngrohjeje, qoftë ai në nivel apartamenti apo në nivel pallati. Mungesa e sistemit qendror të ngrohjes vihet re në të gjitha tipet e ndërtesave pavarësisht vitit të ndërtimit apo llojit të ndërtesës. Vetëm 4.3 % e ndërtesave të shqyrtuara kanë një sistem të tillë, kryesisht në nivel apartamenti dhe karakteristike në njësitë e ndërtuara pas viteve 90-të.

Sjellja Energjitike e Stokut të Ndërtimit

Gjendja aktuale e stokut të banimit, veçanërisht ajo e ndërtuar para viteve 90të, përfshi këtu ndërtesat jo-rezidenciale ashtu dhe ndërtesat publike, paraqesin performancë të ulët energjitike, probleme dhe mangësi në parametrat konstruktiv, etj.

Këto probleme vihen re edhe në ndërtesat e ndërtuara në vitet e fundit, ashtu dhe banesat e reja që po vazhdojnë të ndërtohen në Shqipëri. Ndër problemet kryesore të ndërtesave përmendim humbjet në veshjen e jashtme të ndërtesave (mungesa e termoizolimit, materialet e ndërtimit jo të përshtatshme dhe ventilim i gabuar), humbjet nëpërmjet dritareve, humbjet nga sistemet e ndërtesës, keqpërdorimi dhe keqadministrimi i ndërtesave, pajisjeve, dhe mungesa e standarteve të projektimit dhe kontrollit të tyre.

Potencialet për Kursim dhe Përfitim Ekonomik

Duke marrë në konsideratë problemet e mësipërme dhe stokun e konsiderueshëm që e ka të nevojshëm rehabilitimin, mund të themi se ekziston një potencial i madh për kursimin e energjisë në stokun e ndërtesave, duke ndërmarrë masat e duhura në përmirësimin e ndërtesave dhe sistemeve të tyre.

Disa nga mënyrat kryesore për të rritur efiçiencën energjitike në ndërtesa

Performanca energjitike e ndërtesave mund të përmirësohet duke zbatuar një sërë masash që lidhën me mbulesën e ndërtesës, ashtu dhe me sistemet e ngrohjes- ftohjes, sigurimin e ujit të ngrohtë sanitar, sistemin hidraulikë apo ndriçimit, etj. Disa nga masat më të zakonshme dhe jetëgjatësia e përdorimit të tyre, të përdorura gjerësisht në vendet e BE, janë:

- Termoizolimi i mureve të jashtmes dhe çatisë (30 vite)
- Dritare të reja (30 vite)
- Njësitë e rikuperimit të nxehtësisë dhe sistemet e ventilimit mekanik (15 vite)
- Sistemet e ndriçimit (10 vite)
- Vendosja e paneve diellorë (15 vite)
- Balancimi hidraulik i sistemit të ngrohjes dhe instalimi i valvolave termostat në radiatorë (15 vite)
- Boilier i ri me vaj (qendror) si dhe sistemin e kontrollit automatik (20 vite)
- Boilier me biomasë (qendror) dhe sistemi i kontrollit automatik (20 vite)


Materiale Izoluese Transparente

Një nga teknologjitë që mund të përdoret si pjesë e rehabilitimit energjitik të banesave është ajo e


Termoizolimi i një Pallati Parafabrikat në Fier (Co-PLAN, 2011)



Shembuj të Materialeve Izoluese të Tejdukshme dhe Parimi i MIT







retrofitit të dritareve nëpërmjet materialeve izoluese transparente. Dy nga zbatimet bazë të kësaj teknologjie janë: (1) Ngrohje diellore e murit opak; (2) Qelq izolues me veti për të rregulluar rrjedhën e dritës.

Përparimet teknologjike të tre dhjetëvjeçarëve të fundit kanë krijuar sisteme dhe pajisje që mund të veshin qelq izolues të teknologjisë së lartë me shtresa tepër të holla neutrale duke përdorur procese me kosto të ulët. Kjo ka përmirësuar aftësinë emetuese "λ" të izolimit termik deri në nivelin e ulët 0.02, madje edhe më poshtë, në një kohë që për qelqin normal është 0.89. Megjithatë, nga perspektiva ekonomike ky zhvillim dhe zbatimet e tij në ndërtesat e reja janë vetëm hapi i parë. Hapi tjetër duhet të jetë integrimi i kësaj teknologjie të re të qelqit në miliona metra katrorë sipërfaqe dritaresh e fasadash. Ky proces sot është pothuajse automatik për ndërtesat e reja. Kurse ndërtesat ekzistuese paraqesin një sfidë më të madhe dhe shumë punë për t'u bërë për të shpjeguar dhe bindur që qëllimet ekologjike, ekonomike dhe klimaterike mund të arrihen. Në kohë të rritjes së përhershme të kostove të energjisë për ngrohjen, ky përfitim ekonomik paraqet një argument bindës. Duke bërë një ndryshim të thjeshtë, si vendosja e xhamave, sjell një periudhë amortizimi më të shkurtër por edhe u ofron banorëve përmirësim të dukshëm në rehati dhe komoditet

Parimi

Rrezja e diellit godet materialin ngrohës të vendosur në murin përthithës dhe ai ngrohet, duke e përcjellë ngrohtësinë në dhomat pas tij. Në këtë mënyrë, fasada me sipërfaqe shpërndarëse bëhet një element që grumbullon dhe ruan nxehtësinë. MIT punon për ta shpërndarë rrezatimin që balanca e energjisë për një mur të izoluar me material të tejdukshëm të jetë pozitive për çdo orientim. Orientimi ideal është jugu, jugperëndimi ose juglindja ku mund të përftosh nga kontributi i rritur i rrezatimit diellor. Shtesa e mundshme e energjisë varet nga disa parametra, si klima, orientimi dhe morfologjia e ndërtesës.

Karakteristikat optike dhe termike

"Vlera U" edhe më të ulëta mund të arrihen kur përdoren të ashtuquajturit materiale izoluese të tejdukshme si materiale mbushëse. Në shumicën e rasteve, këto materiale nuk lejojnë pamje të qartë sepse janë struktura gjeometrike (rripa, hoje bletësh, tuba) të bëra nga plastika ose qelqi dhe e shtrembërojnë pamjen, ose ngaqë shfaqin shpërndarje drite në nivele shumë të larta. Për klasën e fundit të materialeve, i ashtuquajturi aeroxhel është kandidati më premtues.

Vetitë termike dhe optike të materialeve izoluese të tejdukshme varen nga materiali, struktura e tij, trashësia, cilësia dhe njëtrajtshmëria. Ato konsistojnë përgjithësisht në qelq apo plastikë të renditur në formën e hojeve të bletës, kapilarëve ose ndërtimeve të mbyllura qelizore. Mund të përdoret edhe silicë aeroxhel granulare ose monolitike për të arritur nivele më të larta izolimi.